

AKTI I THEMELIMIT



Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "BE-IS" Sh.p.k.

Une **Hamz ISLAMAJ**, i biri i Mustaf, lindur me 22.04.1967 ne Kukes dhe banues ne Tirane, Lgj. 8, Rr. "Dervish Hekali", me kombesi dhe shtetsi shqiptare, identifikuar nga Pasaporta Nr. 1626482, si themeluese e kesaj shoqerie me pernjegjesi te kufizuar, ku une jam Ortak i Vetem, sot me daten 15.12.2006 vendosa te hartoj kete Akt-Themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhtme.

Neni 1

Themeluesi krijon nje shoqeri me pernjegjesi te kufizuar, te cilen do ta emertoje Shoqeria Tregetare "**BE-IS**" Sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 5, Tirane. Me vendim te ortakut te vetem, mund te ndryshohet selia e shoqerise, te hapen filiale te saj ose forma te tjera shoqerish ne Tirane dhe ne rrethe te tjera te Shqiperise, ashtu sic dhe do te vleresohet ne te ardhmen nga ortaku i vetem.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet, duke filluar nga momenti i rregjistrimit te saj ne rregjistrin Tregtar

Neni 4

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise te saj:

1. *Ndertime, konstrukSIONE te ndryshme,*
2. *Prodhime, perpunime materiale inerte (ndertimi)*
3. *Perpunim, prodhim lende drusore, alumini dhe hekuri; import dhe eksport te tyre,*
4. *Hapje kurse private te formimit profesional (elektriçist, mekanik, murator, kompjuter, gjuhe te huaja, autoshkolle, etj).*
5. *Punime hidraulike dhe elektrike.*
6. *Punime montimi dhe konstrukSIONE te ndryshme.*
7. *Prodhim materiale ndertimi.*
8. *Transport mallrash dhe materialesh brenda dhe jashte vendit.*
9. *Import-Export mallrash dhe materialesh te ndryshme.*
10. *Import-Export te bimeve medicinale dhe farmaceutike.*

Ortaku i Vetem gezon te drejten te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise sa here ai e ndjen te nevojshme.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise do te jete 100.000 (njeqind mijë) leke, dhe zoterohet i gjithi prej ortakut te vetem.

Neni 6

Kapitali themeltar do te depozitohet prej ortakut te vetem ne nje nga bankat ne Shqiperi ose tek noteri.

Shuma e depozituar vertetohet prej certifikates se konfirmimit bankar ose vertetimit te noterit.

Neni 7

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij Akt-Themelimi edhe ne forma te tjera te percaktuara ne Statutin e saj, i cili pas nenshkrimit nga Ortaku i vetem dhe noterizimi i tyre, do te paraqitet per miratim dhe rregistrim ne Gjykatene e Shkalleve se Pare Tirane, ne diten e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

Neni 8

Ortaku i vetem vendos per prishjen e Shoqerise para mbarimit te afatit ne rast se veprimitaria e saj eshte jo efektive ose per raste te tjera te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 9

Shpenzimet qe do te kryhen deri ne rregistrimin e shoqerise si person juridik do te perfshihen ne bilancin ekonomik e shoqerise.

Ky Akt-Themelimi eshte hartuar ne 5 kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila vlore juridike te njeje me originalin. Nje kopje do te depozitohet tek noteri, nje tjeter do te perdoret per t'u rregistruar ne Deget e Tatimeve dhe kopjet e tjera do te depozitohen ne arkivin e Shoqerise.

THEMELUESI I SHOQERISE
Hamz ISLAMAJ

Hamz Islamaj
[Signature]



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“BE-IS” SH.P.K

HYRJE

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**BE-IS**” Sh.p.k krijohet mbi bazen e iniciativaesh dhe kapitalit themeltar te ortakut themelues, ne baze te Aktit te Themelimit, date 15.12.2006 per te ushtruuar aktivitetin e saj si person juridik i pavarur.

NENI 2

Shoqeria krijohet ne perputhje me Ligjin nr.7688, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregetare” dhe Ligjet 7667, date 28.01.1993 “Per regjistrin tregetar” dhe e zhvillon veprimitarine e saj ne konformitet me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe normat e ketij statuti.

EMERTIMI SELIA OBJEKTI KOHEZGJATJA

EMERTIMI

NENI 3

Emertimi i Shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar eshte “**BE-IS**” Sh.p.k

SELIA

NENI 4

Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar ka Seline e saj ne **Rr. “Abdi Toptani”, Nr.5, Tirane**.


Aktiviteti i Shoqerise do te zhvillohet ne Tirane dhe do te shtrihet ne te gjithe territorin shteteror te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

OBJEKTI.

NENI 5

Objekti veprimitarise te Shoqerise “**BE-IS**” Sh.p.k do te jetë:

1. *Ndertime, konstruksione te ndryshme,*
2. *Prodhime, perpunime materiale inerte (ndertimi)*
3. *Perpunim, prodhim lende drusore, alumini dhe hekuri; import dhe eksport te tyre,*
4. *Hapje kurse private te formimit profesional (elektriçist, mekanik, murator, kompjuter, gjuhe te huaja, autoshkolle, etj).*
5. *Punime hidraulike dhe elektrike.*
6. *Punime montimi dhe konstruksione te ndryshme.*
7. *Prodhim materiale ndertimi.*
8. *Transport mallrash dhe materialesh brenda dhe jashte vendit.*
9. *Import-Export mallrash dhe materialesh te ndryshme.*
10. *Import-Export te bimeve medicinale dhe farmaceutike.*



Ortaku Themelues gezon te drejten te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise sa here ai ta ndjej te nevojshme.

KOHEZGJATJA

NENI 6

Shoqeria themelohet per te ushtruuar veprimtarine e saj per nje periudhe prej mbi 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Per shkaqe dhe arsyte te ndryshme, ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj edhe para ketij afati. Kjo do te behet ne perputhje me Statutin dhe Legjislacionin ne fuqi.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 7

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem Z. Hamz ISLAMAJ.

NENI 8

Kapitali i Shoqerise depozitohet para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

NENI 9

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet ne vartesi te rezultateve te Shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai mund te jete ne leke ose ne valute te huaj.

NENI 10

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 11

Kapitali themeltar eshte lehtesish i transferushem ne rruge trashegimie. Bashkeshorti dhe pasardhesit mund te behen ortake ne Shoqeri nepermjet trasferimit te pjesave te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara me ligj.

NENI 12

Shoqeria mund te kete edhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paqajteshme ne sherbim te shoqerise, si dhe ato te luajteshme, te cilat kalojne ne pronesi te shoqerise.

FONDET E SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria percakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues)
- Fondi rezevre
- Fonde te tjera qe mund te jene te nevojshem gjate veprimtarise te saj

Madhesia e secilit fond, percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

DREJTIMIT ADMINISTRATIV

NENI 14

Shoqeria ka si organ drejtues:

• Asambleja e ortakeve (ortaku i vetem)

• Administratori

Ortak i vetem i shoquerise eshte Z. Hamz ISLAMAJ, i cili njekohesisht eshte dhe Administrator i Shoquerise.

NENI 15

Ortaku i vetem per administrimin e Shoquerise ose te aktiviteve te veçanta te saj ka kompetenca te emeroje nje ose disa persona te tjere, si administratore te Shoquerise. Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre, te leshuar nga Ortaku i vetem.

NENI 16

Shoqeria nuk merr persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem ne mardhenie me persona te trete qe i tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

NENI 17

Veprimtaria e Shoquerise percaktohet nga administratori i saj, ne perputhje me Statutin dhe legjislacionin ne fuqi.

NENI 18

Administratori per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes se registrave te veprimeve kontabele, emeron nje ose disa eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrushem per rastet e parashikuara me ligj.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

NENI 19

Persa kohe qe shoqeria do te jete me nje ortak kompetencat e tij do te jene:

- Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoquerise dhe miraton rregulloret per
- sektoret e veçante te saj.
- Emeron dhe shkarkon administratoret dhe percakton kompetencat e tyre me aktin e emerimit.
- Shqyrton dhe vendos per bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe te fitimit te realizuar.
- Vendos per krijimin e degeve, filjaleve ose perfaqesive te Shoquerise, si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.
- Realizon mardheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare ~~me~~ personat e tjere fizike dhe juridike, perfshire ketu edhe marrjen e kredive.
- Vendos per mbarimin e aktivitetit te Shoquerise, ne se nga dokumentacioni financiar, rezultatet e saj vleresohen me humbje.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NENI 20

Administratori ka keto detyra dhe kompetencia:

- Te punoje, te organizoje dhe te drejtoje ne menyre te tille qe te siguroje sukses te plote te Shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare.
- Te zbatoj vendimet e marra nga ortaku i vetem dhe urdherat e tij te dhena brenda kompetencave te percaktuara ne Statut dhe nga legjislacioni ne fuqi.
- Te paraqese regullisht para ortakut: raportin e administrimit, inventaret e pasurise, bilancin vjetor te llogarive, por jo me vone se 4 muaj nga mbyllja e vitit financiar paraardhes.
- Percaktion dhe realizon çmimet e punimeve te kryera dhe te shitjes te artikujve per treg.
- Vendos per pagat e personelit te Shoqerise.
- Ndjek problemet e Shoqerise ne mardhenjet me organet e ndryshme shtetore dhe me personat e tjere fizike dhe juridike.

MARDHENIET FINANCIARE

NENI 21

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar “BE-IS” shpk, mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore drejtpersedrejti ne tregun e lire, si dhe me personat fizike dhe juridike, vendas ose te huaj.

NENI 22

Ne mardheniet kontraktore, Shoqeria perfaqesohet nga Administratori ose nga persona te autorizuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per Shoqerine.

NENI 23

Shoqeria ka te drekte te çele llogari likujduse prane Bankave te shkalles se dyte, vendase ose te huaja, brenda dhe jashte Shqiperise.

NENI 24

Shoqeria pergjigjet per kontributet fiskale, afatet e derdhjes se tyre dhe sigurimet shoqerore. Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacion te regult financiar. Administratori, ne fund te vitit duhet te dorzoje ne Organet Tatimore bilancin vjetor te llogarive. Viti financiar, fillon me 01 Janar dhe mbyllte me 31 Dhjetor. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen nga ortaku I vetem ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

MARDHENJET E PUNESIMIT

NENI 25

Ortaku i vetem vendos per personat qe do te punesohen ne aktivitetin e shoqerise. Punesimi do te behet ne perputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

NENI 26

Mardhinet e punesimit irregullohen sipas kontrates te punesimit qe lidhet midis paleve ne baze te akteve ligjore e nenligjore ne fuqi. Ne kontrate caktohen: ditet e punes dhe te pushimit, kushtet e punes dhe te pageses, sigurimet shoqerore, etj.

NENI 27

Administratori dhe personeli i Shoqerise, eshte i detyruar te respektoje disiplinen e punes, te ruajte te mirembaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e Shoqerise ne perputhje me ligjin.

NENI 28

Per shkeljet qe ndodhin zbatohen masa disiplinore qe zbatohen nga ortaku i vetem. Punonjesit qe largohen nga puna duhet te bejne dorzimin e detyres ne baze te nje akti me shkrim pasi te kene shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

NENI 29

Cdo punonjes i punesar ne Shoqeri eshte pergjegjes per kryerjen e detyres se ngarkuar. Ai eshte eshte i detyruar te permbushe detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet dhe urdherat e Administratorit si dhe nga Statuti i Shoqerise. Per shkelje te disciplines dhe te regullave ne pune merren masa te ndryshme sipas ligjit.

KOFIDENCIALITETI

NENI 30

Te gjithe personat qe do te punojne ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit, te informacionit, te njozhurive te fituara si dhe te cdo lloj materiali tjeter kofidencial.

Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar nxierjen e materialeve dhe te dhenave konfidencale, qofte dhe pjeserisht.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 31

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve te mundeshme ndaj personave te tret, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem dhe te Administratorit te cilet mund ti depozitoje ato ne nje banke te vendit ose te huaj.

NENI 32

Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuar ne kontraten e punes dhe perqindjeve te fitimit te percaktuar nga ortaku i vetem.

NENI 33

Ne rast te mbarimit te veprimtarise te Shoqerise, fitimi i realizuar duke zbritur apo shtuar shumat nga vitet e kaluara, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.

NENI 34

Çmimet e sherbimeve te ofruara nga Shoqeria si dhe ato te tregetimit caktohen ne baze te përimeve te ekonomise te tregut te lire. Fitimet e realizuara i neneshtrohen tatimit yjetor, sipas percaktimit ne dispozitat perkatese ligjore.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 35

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me vendim te organeve drejtuese, ne rast se kjo veprimtari nuk rezulton fitim prurese, si dhe per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj.

NENI 36

Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te negocimit, nepermjet formave te thithjes ose te bashkimit.

NENI 37

Gjate fazes se likujdimit te Shoqerise, pergjegjesia e administratorit dhe e likujdatorit eshte e njejte.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 38

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne nje nga Institutet ose Shoqerite e Sigurimit.

NENI 39

Mosmarveshjet ne mardheniet me personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, zgjidhja behet nga Gjykata.

NENI 40

Shoqeria ka vulen e saj. Forma dhe permbajtja e saj percaktohet nga ortaku i vetem.

Statuti i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**BE-IS**” Sh.p.k u miratua nga ortaku i vetem dhe u neneshkrua prej tij sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

Hamz ISLAMAJ

